



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351-196876

Dt. 21.11.2016

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e **Vera Koshi** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Vatra Shqiptare”** në bazë të neneve 3-1.7, 1.17;1.11;1.11.1 dhe të nenit 14.1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. e në lidhje me nenin 84. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

## A K T V E N D I M

I. **ILEJOHET: Vera Koshi** ndërtimin e objektit - **Shtëpi individuale** në Prizren në vendin e ashtuquajtur / \_\_\_ rrugën **“Gucia” nr. 99/19** në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. **04-353-147964 e lidhur me kërkesën nr.04-353-29648 të datës 22.02.2016** si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e **“Hyllus” SH.P.K.**

II. Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit **veçantë.**

III. Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **13005.83€.**

IV. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga paralogaria e vlerës së objektit.

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.

VI. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.

VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.

VIII. Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës

IX. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).

X. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK,KEDS-it, dhe avari tjera ti evitohet dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi

.../...

## Arsyetim

**Parashtruesi i kërkesës: Vera Koshi nga Prizreni** me banim në rrugën **“Gucia” nr. 99/19** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për ndërtimin e **objektit - Shtëpi individuale.**

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, pëlqimet e kërkuara të parashtruara, Aktvendimin mbi lokacionin, si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtim e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.

Nga se u tha më lartë u muar aktvendimi si në dispozitiv.

**KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE;** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Hartuan

Bashkëpunëtorët profesional:

  
**Xhejlane Gjini, inxh.dipl.ark.**

  
**Arben Shala, jur.dipl.**

Kontrolloi:

  
**Afërdita Mormorina, inxh.dipl.ark.**

DREJTORI:

  
**Vasil Islamaj**

